

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: SHËRBIME KONSULENCE PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT TË KUADRIT STRATEGJIK DHE OPERACIONAL TË BANKËS SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT (BZH).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 72221000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 315,849,000 (Treqind e pesëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e nëntë mijë) Lekë, pa TVSH, ose 3,310,786.16 (Tre milion e treqind e dhjetë mijë e shatëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) euro, pa TVSH.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (95.40), datë 22.05.2026)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron e tyre vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023–2024–2025). Vlera e

xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, si dhe nenit 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr 7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, me qëllim garantimin që operatorët ekonomikë disponojnë stabilitet financiar dhe kapacitete ekonomike të mjaftueshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku të paktën dy prej tyre duhet të shoqërohen me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri është vendosur bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 43, pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve financiare për paraqitjen e bilanceve është bërë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe financiar në fuqi, konkretisht ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë se procedura aktuale e prokurimit zhvillohet gjatë periudhës maj-qershor, autoriteti kontraktor ka vlerësuar se operatorët ekonomikë mund të mos kenë ende të finalizuara dhe të certifikuara pasqyrat financiare për vitin financiar më të fundit (2025) në momentin e dorëzimit të ofertave, për shkak se pasqyrat financiare të certifikuara, finalizohen përgjithësisht në fund të muajit qershor. Me qëllim shmangien e krijimit të barrave administrative

joproporcionale ose kufizimeve të pajustificuara në pjesëmarrje, kërkesa për paraqitjen e pasqyrave financiare të certifikuara është kufizuar, për rrjedhojë, vetëm për dy vite financiare.

Njëkohësisht, operatorët ekonomikë mbeten të detyruar të paraqesin bilancet vjetore për tre vitet e fundit financiare, me qëllim evidentimin e vazhdimësisë së aktivitetit dhe qëndrueshmërisë financiare.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomikë disponojnë kapacitet financiar dhe qëndrueshmëri ekonomike për realizimin e kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë e Mëparshme e Ngjashme

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.**

Operatori ekonomik mund të dëshmojë përmbushjen e kërkesës për shërbime të mëparshme të ngjashme përmes shërbimeve të realizuara nga vetë Ofertuesi ose nga grupi, rrjeti, partneriteti, organizata apo entitete të lidhura pjesë e të cilave ai bën pjesë, me kusht që Ofertuesi të provojë disponueshmërinë efektive të burimeve teknike, menaxheriale dhe profesionale të nevojshme për realizimin e Kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- **për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- **për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën dhe kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është përcaktuar në përpjesëtim me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe moskufizimit të konkurrencës.

Argumentim mbi provimin e shërbimeve të ngjashme përmes shërbimeve të realizuara ose nga vetë Ofertuesi, ose nga grupi i integruar ndërkombëtar, rrjeti, partneriteti, organizata e afiluar apo entitetet e lidhura të grupit ku Ofertuesi bën pjesë, me kusht që Ofertuesi të provojë se burimet përkatëse teknike, menaxheriale dhe profesionale janë efektivisht në dispozicion për realizimin e Kontratës: Ky parashikim është përfshirë me qëllim garantimin e konkurrencës së ndershme, proporcionalitetit dhe aksesit efektiv në kapacitetin teknik të specializuar të kërkuar për realizimin e detyrës. Objekti i prokurimit është kompleks, shumëdisiplinor dhe kërkon eksperiencë në strategji, planifikim biznesi, ngritje institucionale, qeverisje, implementim PMO-je, menaxhim risku, ICT, burime njerëzore, operacione dhe kuadre të bankave zhvillimore/sectorit financiar. Një eksperiencë e tillë mund të gjendet legjitimisht brenda një grupi të integruar ndërkombëtar, rrjeti, partneriteti, organizate të afiluar ose entiteti të lidhur, ndërkohë që ofertuesi lokal ose pjesëmarrës mbetet përgjegjës për paraqitjen e ofertës dhe zbatimin e kontratës.

Ky parashikim është në përputhje me nenin 84 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 90 të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, të cilat lejojnë një operator ekonomik të mbështetet në kapacitetet ekonomike, financiare, teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve me to, me kusht që të provohet disponueshmëria e burimeve të nevojshme për realizimin e kontratës.

Ky parashikim nuk lejon mbështetje abstrakte ose thjesht formale mbi eksperiencën në nivel grupi. Ai kushtëzohet shprehimisht në detyrimin që ofertuesi të provojë se burimet përkatëse teknike, menaxheriale dhe profesionale janë realisht në dispozicion për realizimin e kontratës. Për rrjedhojë, ruhet e drejta e autoritetit kontraktor për të verifikuar kapacitetin real, parandalohet mbështetja mbi referenca të pazbatueshme në praktikë dhe mbështetet përzgjedhja e një operatori të aftë për të realizuar shërbimet e kërkuara.

2.3.2 Certifikimet e Kërkuara

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikata të vlefshme, me fushë certifikimi që lidhet me objektin e prokurimit, si më poshtë:

Standardi	Përshkrimi	Statusi
SSH EN ISO 9001	Sistemet e menaxhimit të cilësisë	Originale ose ekuivalente/të barazvlefshme

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

SSH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/të barasvlefshme, lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, i cili përfshin shërbime konsulence strategjike, planifikim institucional dhe mbështetje për implementim dhe PMO.

Ky standard garanton që operatori ekonomik disponon procedura dhe sisteme të strukturuar për menaxhimin e proceseve, kontrollin e cilësisë së shërbimeve, koordinimin e aktiviteteve dhe monitorimin e performancës gjatë realizimit të kontratës.

Duke qenë se kontrata përfshin produkte strategjike, koordinim të proceseve të implementimit dhe monitorim të aktiviteteve të projektit, shihet e nevojshme që operatorët ekonomikë të provojnë disponimin e standardeve të certifikuara të menaxhimit të cilësisë, me qëllim garantimin e realizimit efektiv dhe cilësor të shërbimeve të objekt prokurimit.

2.3.3 Profilet Profesionale të Kërkuara

Operatori ekonomik duhet të disponojë një staf prej të paktën pesëmbëdhjetë (15) punonjësish. Për verifikimin e përmbushjes së këtij kriteri, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e listëpagesave, ose dokumentacion ekuivalent për subjektet e huaja (sipas legjislacionit të zbatueshëm në juridiksionin përkatës), që i referohet muajit më të fundit që paraprin afatit për dorëzimin e ofertave.

Ofertuesi duhet të angazhojë staf të kualifikuar, që pasqyron natyrën dhe ekspertizën e nevojshme për realizimin e secilit aktivitet në kuadër të secilës shtyllë, në përputhje me profilet profesionale të mëposhtme:

Pozicionet e Stafit	Kërkesat për Kualifikim
Partner	<p>Diplomë Master në financë, ekonomi, administrim biznesi, kontabilitet, bankë, menaxhim, drejtësi, sisteme informacioni me minimumi dhjetë (10) vite eksperiencë profesionale nga data e diplomimit.</p> <p>Minimumi tetë (8) vite eksperiencë të provuar në ofrimin e shërbimeve të konsulencës për institucione financiare, banka zhvillimi, institucione financiare publike evropiane ose subjekte të krahasueshme.</p> <p>Dokumentacioni për verifikim: CV e detajuar e stafit në nivel Partner.</p>

	<p>Njohuri të gjuhës angleze, minimumi niveli C1 ose ekuivalent.</p> <p>Dokumentacioni për verifikim: Duhet të paraqitet një certifikatë ndërkombëtarisht e njohur e gjuhës angleze ose dokumentacion që vërteton përfundimin e studimeve universitare në gjuhën angleze.</p>
Menaxher/ I Lartë	<p>Diplomë Master në financë, ekonomi, administrim biznesi, kontabilitet, bankë, menaxhim, drejtësi, sisteme informacioni.</p> <p>Minimumi gjashtë (6) vite eksperiencë relevante në strategji, planifikim industrial, menaxhim projektsh (PMO), shërbime financiare, institucione publike zhvillimi ose angazhime të krahasueshme.</p> <p>Dokumentacioni për verifikim: CV e detajuar e stafit në nivel Manager.</p> <p>Eksperiencë e provuar në koordinimin e ekipeve të projektit, duke përfshirë planifikimin e aktiviteteve dhe monitorimin e progresit.</p> <p>Njohuri të gjuhës angleze, minimumi niveli C1 ose ekuivalent.</p> <p>Dokumentacioni për verifikim: Duhet të paraqitet një certifikatë ndërkombëtarisht e njohur e gjuhës angleze ose dokumentacion që vërteton përfundimin e studimeve universitare në gjuhën angleze.</p>
Niveli Fillestar (Junior)	<p>Diplomë Bachelor në financë, ekonomi, administrim biznesi, kontabilitet, bankë, menaxhim, drejtësi, sisteme informacioni, inxhinieri ose çdo profesion tjetër të përshtatshëm me natyrën e shërbimit.</p> <p>Minimumi tre (3) vite eksperiencë profesionale, të llogaritura nga data e diplomimit.</p> <p>Dokumentacioni për verifikim: CV e detajuar e ekspertit të Nivelit Fillestar.</p> <p>Njohuri të gjuhës angleze, minimumi niveli C1 ose ekuivalent. Duhet të paraqitet një certifikatë ndërkombëtarisht e njohur e gjuhës angleze ose dokumentacion që vërteton përfundimin e studimeve universitare në gjuhën angleze.</p>

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Qëllimi i këtij kriteri është të garantojë që operatori ekonomik disponon personel të kualifikuar dhe me eksperiencë profesionale të përshtatshme për realizimin me sukses të kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë strategjike të shërbimeve objekt prokurimi.

Termet e Referencës kërkojnë që Kontraktori të realizojë shërbime në kuadër të Shtyllës 1 – Këshillim Strategjik, Shtyllës 2 – Mbështetje për Implementimin dhe PMO-në, si dhe një kuadër ndërsektorial për verifikimin dhe certifikimin. Shërbimi përfshin strategji, planifikim biznesi, analiza krahasuese, modelim financiar, qeverisje, PMO, mbështetje ligjore dhe të qeverisjes, financim dhe çështje financiare, produkte biznesi, menaxhim risku dhe mbikëqyrje, TIK dhe operacione, burime njerëzore dhe organizim, koordinim me palët e interesit, dokumentacion provues, sigurim cilësie dhe procedura certifikimi.

Duke marrë në konsideratë numrin e linjave të punës, mundësinë e zbatimit paralel të Shtyllës 1 dhe Shtyllës 2, afatet strikte, si dhe nevojën për vazhdimësi, kontroll cilësie dhe kapacitet zëvendësues, autoriteti kontraktor duhet të garantojë që operatori i përzgjedhur disponon një bazë minimale të qëndrueshme personeli. Një ofertues me personel të pamjaftueshëm mund të mos jetë në gjendje të mbulojë disiplinat e kërkuara, të menaxhojë linja pune paralele, t'u përgjigjet komenteve dhe kërkesave, të administrojë dokumentacionin provues dhe dosjet e certifikimit, apo të garantojë realizimin e pandërprerë të kontratës përgjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Kërkesa për të paktën pesëmbëdhjetë (15) të punësuar është proporcionale me objektin dhe kompleksitetin e shërbimit, si dhe synon të garantojë që ofertuesi disponon një strukturë minimale organizative të aftë për të mbështetur ekspertët e propozuar dhe për të realizuar me sukses kontratën. Përbushja e këtij kriteri është objektivist e verifikueshme përmes dokumentacionit të listëpagesave ose provave ekuivalente për subjektet e regjistruara jashtë vendit.

Kriteri është hartuar në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë që lidhen me secilin profil të kërkuar.

Partner: Kërkesa për ekspertë në nivel Partner është përcaktuar duke marrë në konsideratë rolin drejtues dhe strategjik që këta ekspertë do të kenë gjatë realizimit të projektit. Në përputhje me detyrat e përcaktuara në Termat e Referencës, ekspertët në nivel Partner do të jenë përgjegjës për orientimin metodologjik të projektit, hartimin, rishikimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe operacionale, koordinimin institucional me palët e interesit, si dhe mbikëqyrjen e proceseve të implementimit dhe realizimit të aktiviteteve kryesore.

Menaxher/I Lartë: Kërkesa për ekspertë në nivel Menaxher/I Lartë lidhet me nevojën për koordinim operacional, menaxhim të aktiviteteve dhe ndjekje të proceseve të implementimit gjatë realizimit të projektit. Në përputhje me detyrat e përcaktuara në Termat e Referencës, këta ekspertë do të jenë përgjegjës për koordinimin e ekipeve të punës, monitorimin e progresit të projektit, raportimin periodik, menaxhimin e produkteve të kontratës dhe mbështetjen e proceseve të implementimit dhe PMO.

Niveli Fillestar (Junior): Kërkesa për ekspertë në nivel Fillestar (Junior) është përcaktuar për të garantuar mbështetje teknike, analitike dhe administrative gjatë realizimit të projektit. Në përputhje me detyrat e përcaktuara në Termat e Referencës, ekspertët Junior do të asistojnë në përgatitjen e analizave dhe dokumentacionit teknik, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, koordinimin e aktiviteteve dhe dokumentacionit të projektit, si dhe në mbështetjen e proceseve të implementimit dhe raportimit.

2.3.4 Deklaratë e Angazhimit të Stafit

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për angazhimin dhe disponueshmërinë e stafit të propozuar për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/d të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin e disponueshmërisë dhe angazhimit të stafit të propozuar për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës, janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Banka Shqiptare e Zhvillimit”, bazuar në nevojat e të cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në dokumentacionin e përcjellë nga BZH përcaktohet se:

Banka Shqiptare e Zhvillimit, e themeluar në zbatim të Ligjit nr. 23/2025 "Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit" dhe të Statutit të saj, është një institucion me rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik të vendit, me mision mbështetjen e investimeve prioritare, rritjen e aksesit në financim dhe forcimin e instrumenteve të politikës zhvillimore, në përputhje me praktikën më të mirë evropiane dhe ndërkombëtare. Në këtë fazë fillestare të krijimit dhe operacionalizimit të saj, paraqitet thelbësore sigurimi në kohë i ekspertizës së specializuar ndërkombëtare, me qëllim hartimin dhe konsolidimin e kuadrit institucional, strategjik dhe operacional të Bankës, duke mundësuar funksionimin efektiv dhe në përputhje me standardet më të mira të qeverisjes dhe menaxhimit.

Termat e Referencës janë hartuar për të adresuar nevojat e zhvillimit institucional të Bankës Shqiptare të Zhvillimit sh.a., siç rrjedhin nga Kuadri i Përkohshëm Organizativ dhe Strategjik për Zhvillimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit sh.a. (Projekt-Plan/Blueprint), miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës më 22.01.2026. Projekt-Plani përcakton drejtimin strategjik, organizativ dhe

operacional të zhvillimit të BZH-së si një bankë zhvillimi / Institucion Kombëtar Promovues i sapokrijuar.

Termet e Referencës e materializojnë Projekt-Planin në një dokument prokurimi konkret, të bazuar në produkte të matshme dhe të zbatueshëm nga ana kontraktuale. Qëllimi i tyre është të përcaktojnë objektivat, fushëveprimin, produktet, afatet, modalitetet e zbatimit, standardet e cilësisë, evidencat e verifikimit dhe procedurat e certifikimit të nevojshme për angazhimin e një kontraktori që do të mbështesë BZH-në në zhvillimin e kuadrit të saj strategjik dhe operacional.

Objekti i shërbimeve justifikohet nga faza e zhvillimit institucional dhe nevojat për gatishmëri operacionale të BZH-së. Banka kërkon mbështetje të integruar në këshillimin strategjik, planifikimin e biznesit, ngritjen institucionale, qeverisjen, modelimin financiar, strukturimin e financimit dhe menaxhimin e thesarit, zhvillimin e produkteve, menaxhimin e riskut, mbikëqyrjen, TIK-un, operacionet, burimet njerëzore, mbështetjen PMO, koordinimin e shtyllave të punës, koordinimin me palët e interesit, verifikimin, pranimin dhe certifikimin e produkteve. Këta komponentë janë të ndërvarur dhe duhet të zhvillohen në mënyrë të koordinuar për të garantuar që Projekt-Plani të përkthehet në struktura praktike operacionale.

Termet e Referencës janë strukturuar rreth Shtyllës 1 – Këshillimi Strategjik, Shtyllës 2 – Mbështetja për Zbatim dhe PMO, si dhe një Kuadri Ndërsektorial të Verifikimit dhe Certifikimit. Kjo strukturë justifikohet pasi produktet strategjike të Shtyllës 1 përbëjnë kuadrin udhëzues për aktivitetet zbatuese në kuadër të Shtyllës 2. Kuadri i PMO-së dhe certifikimit është i nevojshëm për të garantuar koordinimin, gjurmueshmërinë, kontrollin e cilësisë, pranimin e produkteve dhe lidhjen e pagesave me produktet e verifikuara.

Afatet, produktet dhe kërkesat për evidencë të përfshira në Termet e Referencës janë të nevojshme për t'i mundësuar Autoritetit Kontraktor monitorimin e zbatimit, verifikimin e përfundimit, certifikimin e realizimit të rregullt të shërbimeve dhe mbrojtjen e përdorimit eficient të fondeve publike. Termet e Referencës përcaktojnë kritere objektive pranimi dhe kërkesa për evidencë për secilin produkt, duke reduktuar paqartësitë gjatë zbatimit të kontratës dhe duke garantuar një kuptim të njëjtë nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Për rrjedhojë, Termet e Referencës janë teknikisht dhe ligjërisht të justifikuara, proporcionale me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës, të lidhura drejtpërdrejt me Projekt-Planin e miratuar dhe objektivat e gatishmërisë operacionale të BZH-së, si dhe të përshtatshme për t'u përfshirë në dokumentet e tenderit në përputhje me nenin 2, pika 2, shkronja "c", dhe nenin 78, pika 4, të VKM-së nr. 285/2021, i ndryshuar.

Specifikimet teknike dhe termet e referencës janë pjesë e pandarë e DST.

Argumentimi i kriterëve të pikëzuara dhe mënyra e llogaritjes së pikëve:

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”), konkretisht pika 1 e nenit 87 të LPP, ku parashikohet se: “Autoritetet/entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme”, të cilat lënë në diskrecionin e AK-së përcaktimin e mënyrës së vlerësimit, si dhe në VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter vlerësimi ofertën ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto.

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin shërbime me natyrë intelektuale dhe konsulence, autoriteti kontraktor vlerëson se përdorimi i ofertës ekonomikisht më të favorshme mbi bazën e kostos siguron një vlerësim më të plotë të cilësisë së propozimit teknik, metodologjisë së zbatimit dhe kapaciteteve profesionale të operatorëve ekonomikë, në përputhje me kërkesat e kontratës.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Tenderi Ekonomikisht Më i Favorshëm përzgjidhet bazuar në cilësi dhe çmim.

A) ÇMIMI

Sipas rëndësisë, si më poshtë:

- | | |
|--|------------------|
| 1. Propozimi Financiar i Shtyllës 1 | – 10 pikë |
| 2. Propozimi Financiar i Shtyllës 2 | – 10 pikë |
| 3. Propozimi Teknik | – 80 pikë |

Shënim: Për qëllimet e këtij dokumenti, termi “Formula” i referohet metodologjisë së llogaritjes të përcaktuar në nenin 45 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi i Kritereve të Pikëzuara dhe Metodologjia e Llogaritjes së Pikëve

- | | |
|---|------------------|
| 1. <u>Propozimi Financiar i Shtyllës 1</u> | – 10 pikë |
|---|------------------|

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

Pe- Pikët për propozimin financiar për Shtyllën 1

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

Formula:

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

2. Propozimi Financiar i Shtyllës 2

– 10 pikë

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

Pe- Pikët për propozimin financiar për Shtyllën 1

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

Formula:

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

Çmimi më i ulët do të marrë 10 pikë për Shtyllën 1 dhe Shtyllën 2. Çmimet e tjera të ofruara do të vlerësohen proporcionalisht në një shkallë zbritëse, nga çmimi më i ulët drejt çmimit më të lartë.

B) PROPOZIMI TEKNIK

Kriteret e Vlerësimit Teknik

Përmbledhje e Kritereve të Vlerësimit

Nr.	Kriteri	Pikët maksimale	Referencë
2.1	Eksperienca në Angazhime të Ngjashme	0–25 pikë	Section 2.1
2.2	Kualifikimet dhe Kompetencat Profesionale të Stafit	0–20 pikë	Section 2.2
2.3	Metodologjia e Zbatimit të Projektit	0–35 pikë	Section 2.3
	TOTAL	0–80 pikë	

2.1 Eksperienca në Angazhime të Ngjashme

(0-25 pikë)

Kriteri	Përshkrimi
Eksperienca Ndërkombëtare, Rajonale dhe Lokale (0–25 pikë)	Angazhime ose aktivitete të ngjashme apo të krahasueshme do të nënkuptojnë shërbime konsulence që mbulojnë një ose më shumë nga fushat e mëposhtme: strategji, planifikim industrial dhe financiar shumëvjeçar, ngritje institucionale, qeverisje, PMO/zbatim, kornizë gjithëpërfshirëse të menaxhimit të riskut dhe zbatimin e saj, strategji TIK, kursime postare ose operacione, të ofruara për institucione financiare (duke përfshirë NPI-të, bankat e zhvillimit, bankat tregtare të mëdha ose të listuara, institucionet financiare publike dhe IFI-të), veçanërisht ato që operojnë sipas ose janë të harmonizuara me kornizat rregullatore dhe

	statistikore të BE-së (p.sh. EBA, ECB, Eurostat/ESA) në shtetet anëtare të BE-së ose në vendet candidate për anëtarësim në BE.
Metoda e Vlerësimit	Vlerësimi do të bazohet në kompleksitetin dhe vlerën financiare të kontratës. Sa më e lartë të jetë vlera financiare e kontratës kualifikuese, aq më i lartë do të jetë vlerësimi i dhënë ofertuesit, në përputhje me formulën.
Pikët maksimale	Ofertuesi me vlerën më të lartë financiare do të marrë pikët maksimale prej 25 pikësh. Ofertuesit do të renditen proporcionalisht në një shkallë rritëse, në përputhje me formulën: Për këtë kriter zbatohet formula si më poshtë: $P_k = O_k \times P_{maxk} / V_{maxk}$ Vmaxk _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet Pmaxk _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet Ok _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.
Dokumentacioni	Duhet të paraqiten provat e mëposhtme: a) Për eksperiencën me sektorin publik: Vërtetime të lëshuara nga institucionet publike përkatëse që konfirmojnë realizimin me sukses të kontratës, duke specifikuar vlerën, datën e përfundimit, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të lëshuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të deklaruara pranë autoriteteve tatimore ku të pasqyrohen datat, shumat dhe shërbimet e ofruara. b) Për eksperiencën me sektorin privat: Vetëm faturat tatimore të shitjes të lëshuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të deklaruara pranë autoriteteve tatimore, ku pasqyrohen datat, vlerat dhe shërbimet e ofruara, do të pranohen si prova.

2.2 Kualifikimet dhe Kompetencat Profesionale të Stafit

(0-20 pikë)

Kërkesa të Përgjithshme për Përbërjen e Grupeve të Punës

| Nr. | Kërkesa |

Profilet profesionale të propozuara nga ofertuesi duhet të përfshihen brenda kategorive të përshkruara më poshtë. CV-të e paraqitura si pjesë e ofertës duhet të jenë nominative. Çdo zëvendësim personeli do t'i nënshtrohet miratimit paraprak me shkrim nga BZH. Zëvendësimi i personelit të nivelit Partner do të lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet. Angazhimi dhe integrimi i personelit zëvendësues do të jetë me kosto të Kontraktorit dhe nuk duhet të shkaktojë vonesa në dorëzimin e produkteve/shërbimeve.

➤ **Kualifikimi dhe kompetencat profesionale te stafit në nivel Partner (deri në 10 pikë)**

Kriteri	Pikët	Përshkrimi/Detajet
		<p>Partneri duhet të ketë minimumi dhjetë (10) vite eksperiencë profesionale nga data e diplomimit dhe të paktën tetë (8) vite eksperiencë të provuar në ofrimin e shërbimeve të konsulencës për institucione financiare, banka zhvillimi, institucione financiare publike evropiane ose subjekte të krahasueshme.</p> <p>Partneri me numrin më të lartë të viteve të eksperiencës do të marrë pikëzimin maksimal prej 5 pikësh. Partnerët do të vlerësohen proporcionalisht në rend rritës.</p>

Eksperienca profesionale

0-5

Për këtë kriter zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = \frac{Ok \times P_{maxk}}{V_{maxk}}$$

V_{maxk} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Dokumentacioni: CV e detajuar e stafit në nivel Partner.

Partneri duhet të zotërojë të paktën një diplomë Master nga një institucion i akredituar në financë, ekonomi, administrim biznesi, kontabilitet, sektorin bankar, menaxhim, drejtësi, sisteme informacioni ose fusha të tjera të lidhura me objektin e angazhimit. Vlerësim shtesë do t'u jepet gradave PhD/Doktoraturë dhe certifikimeve profesionale ndërkombëtare të njohura të nivelit të lartë në fushën e menaxhimit të projekteve, financës, menaxhimit të riskut, teknologjisë së informacionit, përputhshmërisë (compliance) ose fushave të tjera të lidhura me fushëveprimin e angazhimit.

Për këtë kriter, zbatohet pikëzimi si më poshtë:

Kualifikimet

0-3

Pikët do të akordohen në mënyrë kumulative, bazuar në kualifikimet akademike të kandidatit (Phd/ Doktoraturë) si dhe certifikimet profesionale përkatëse, në përputhje me tabelën e mëposhtme.

Kualifikimi / Certifikimi	Pikë
Mungesa e gradës PhD / Doktoraturë	0 pikë
Gradë PhD / Doktoraturë	1 pikë
Mungesa e certifikimit profesional përkatës	0 pikë

Kriteri	Pikët	Përshkrimi/Detajet
	Një (1) certifikim profesional përkatës	1 pikë
	Më shumë se një (1) certifikim profesional përkatës	2 pikë

Dokumentacioni: Kopje të diplomave, certifikimeve profesionale dhe CV e detajuar e stafit në nivel Partner.

Partneri duhet të ketë:

- a) Njohuri të thelluara mbi kontekstin referues në të cilin operojnë institucionet e zhvillimit dhe mbi palët e interesuara përkatëse;
- b) Aftësi për të monitoruar në mënyrë sistematike ecurinë e projekteve komplekse, duke parashikuar problematika të mundshme kritike dhe duke propozuar në mënyrë proaktive zgjidhje të përshtatshme.

Vlerësimi për kriterin e kompetencës profesionale do të vlerësohet nëpërmjet numrit të projekteve dhe angazhimeve të realizuara për institucione financiare me mandat zhvillimi, përfshirë Institucionet Kombëtare Promovuese (NPI-të) dhe bankat e zhvillimit. Partneri që paraqet kombinimin më të lartë të kriterëve të mësipërme do të marrë maksimumin prej 2 pikësh. Partnerët do të vlerësohen proporcionalisht, sipas një shkalle rritëse.

Kompetenca profesionale

0-2 **Për këtë kriter zbatohet formula si më poshtë:**

$$P_k = \frac{O_k \times P_{\max k}}{V_{\max k}}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepën kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Dokumentacioni për verifikim: CV e detajuar e Partnerit.

➤ **Kualifikimi dhe kompetencat profesionale te stafit në nivel Menaxher / I Lartë (deri në 6 pikë)**

Kriteri	Pikët	Përshkrimi/Detajet
Eksperiencia profesionale	0-3	Kandidati duhet të ketë të paktën gjashtë (6) vite eksperiencë relevante në strategji, planifikim industrial, menaxhim projektesh (PMO), shërbime financiare, institucione publike zhvillimi ose angazhime të krahasueshme.

Kriteri	Pikët	Përshkrimi/Detajet
---------	-------	--------------------

Menaxheri me numrin më të lartë të viteve të eksperiencës do të marrë pikëzimin maksimal prej 3 pikësh. Menaxherët e tjerë do të vlerësohen në rend rritës.

Për këtë kriter zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max k} / V_{\max k}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Dokumentacioni: CV e detajuar e stafit në nivel Manager.

Stafi nivel Menaxher/ Nivel I Lartë duhet të zotërojë të paktën një diplomë Master nga një institucion i akredituar në financë, ekonomi, administrim biznesi, kontabilitet, bankë, menaxhim, drejtësi, sisteme informacioni ose fusha të tjera të lidhura me objektin e angazhimit. Vlerësim shtesë do t'u jepet certifikimeve profesionale ndërkombëtare të njohura në fushën e menaxhimit të projekteve, financës, menaxhimit të riskut, teknologjisë së informacionit, pajtueshmërisë ose fushave të tjera të lidhura me objektin e angazhimit.

Për këtë kriter do të aplikohet formula më poshtë:

Kualifikimet	0-2	Pikët do të akordohen në mënyrë kumulative, bazuar në zotërimin e certifikimeve profesionale përkatëse, në përputhje me tabelën e mëposhtme.
--------------	-----	--

Kualifikimi / Certifikimi	Pikë
Mungesa e certifikimit profesional përkatës	0 pikë
Një (1) certifikim profesional përkatës	1 pikë
Më shumë se një (1) certifikim profesional përkatës	2 pikë

Dokumentacioni: Kopje të diplomave, certifikimeve profesionale dhe CV e detajuar e stafit në nivel Manaxher.

Kriteri	Pikët	Përshkrimi/Detajet
---------	-------	--------------------

Menaxherët duhet të kenë:

- Përvojë të provuar në koordinimin e ekipeve të projekteve, duke përfshirë planifikimin e aktiviteteve dhe monitorimin e progresit;
- Njohuri të thelluara mbi metodologjitë që lidhen me përcaktimin e strategjive korporative, si dhe me hartimin e iniciativave me nivel të lartë inovacioni;
- Njohuri të thelluara mbi metodologjitë dhe mjetet e planifikimit strategjik. Njohja e metodologjive dhe mjeteve të kontrollit menaxherial do të konsiderohet avantazh;
- Aftësi të forta në zgjidhjen e problemeve dhe kapacitete analitike sasiore.

Kompetenca
Profesionale

0-1

Vlerësimi për kriterin e kompetencës profesionale do të bazohet në numrin e projekteve dhe angazhimeve të realizuara për institucione financiare me mandat zhvillimi, përfshirë Institucionet Kombëtare Promovuese (NPIs) dhe bankat e zhvillimit. Menaxheri që paraqet nivelin më të lartë sipas këtij kriteri do të marrë maksimumin prej 1 pikë. Kandidatët e tjerë do të vlerësohen proporcionalisht, sipas një shkalle rritëse.

Për këtë kriter, zbatohet formula e mëposhtme:

$$P_k = O_k \times P_{\max} / V_{\max}$$

V_{\max} – vlera më e lartë e ofruar për kriterin që po vlerësohet;

P_{\max} – numri maksimal i pikëve të caktuara për kriterin që po vlerësohet;

O_k – treguesi i ofertës për kriterin që po vlerësohet.

➤ **Kualifikimi dhe kompetencat profesionale te stafit në nivel Fillestar (Junior) (deri në 4 pikë)**

Kriteri

Pikët

Përshkrimi/Detajet

Kandidati duhet të ketë të paktën tre (3) vite eksperiencë profesionale nga data e diplomimit. Junior-i me numrin më të lartë të viteve të eksperiencës do të marrë pikëzimin maksimal prej 2 pikësh. Junior-ët e tjerë do të vlerësohen në rend rritës.

Eksperiencia
profesionale

0-2

Për këtë kriterin zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max} / V_{\max}$$

V_{\max} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{\max} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Metodologjia e zbatimit të projektit, e cila do të përbëjë pjesë integrale të kontratës së bashku me Termat e Referencës, duhet të përshkruajë dhe të trajtojë, pa kufizim, të gjitha kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës.

Kriteri	Pikët	Përshkrimi/Detajet
----------------	--------------	---------------------------

Metodologjia e propozuar duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës dhe të adresojë në mënyrë gjithëpërfshirëse Shtyllën 1 dhe Shtyllën 2. Ajo duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar mënyrën se si kontraktori koncepton realizimin e angazhimit, qasjen e propozuar për zbatimin e Shtyllës 1 dhe Shtyllës 2, planin e implementimit, si dhe strukturën organizative të stafit të propozuar për realizimin e shërbimeve. Metodologjia nuk duhet të përmbajë komente, kushte apo përjashtime. Metodologjia e vlerësuar si më e mira do të marrë pikëzimin maksimal prej 15 pikësh, ndërsa ofertat e tjera do të vlerësohen proporcionalisht sipas rendit zbritës. Ofertuesi i cili nuk paraqet metodologji dhe kufizohet vetëm në referimin e Termave të Referencës do të vlerësohet me 0 pikë.

Për këtë kriter do të zbatohet skema e mëposhtme e pikëzimit:

1. Përputhshmëria, plotësimi dhe kuptimi i Termave të Referencës — 0–4 pikë

Cilësia e metodologjisë

0–15 Ky kriter vlerëson nëse metodologjia demonstroi kuptim të plotë të angazhimit dhe mbulim të plotë të kërkesave të Termave të Referencës.

Pikët Përshkrimi

0 Metodologjia nuk është paraqitur, thjesht përsërit Termat e Referencës ose nuk demonstroi kuptim të angazhimit.

1 Metodologjia demonstroi kuptim të kufizuar dhe mbulon vetëm pjesërisht Termat e Referencës; mungojnë kërkesa, produkte, afate ose shtylla të rëndësishme.

2 Metodologjia demonstroi kuptim të përgjithshëm dhe mbulon kërkesat kryesore të Termave të Referencës, por paraqet mangësi, përshtatje të kufizuara ndaj kontekstit të BZH-së ose shpjegim të pamjaftueshëm të strukturës me dy shtylla.

3 Metodologjia demonstroi kuptim të mirë të kontekstit të BZH-së, objektive të angazhimit, Shtyllës 1, Shtyllës 2, deliverables, afateve dhe rezultateve të pritshme, me vetëm mangësi të vogla jo materiale.

- 4 Metodologjia demonstroi kuptim gjithëpërfshirës të kontekstit institucional të BZH-së, qëllimit të angazhimit, strukturës me dy shtylla, objektivit të përgatitjes operacionale, produkteve, kërkesave për dokumentacion provues, logjikës së pranimit dhe kuadrit të certifikimit.

2. Qasja teknike për Shtyllën 1 dhe Shtyllën 2 — 0–5 pikë

Ky kriter vlerëson përmbajtjen dhe besueshmërinë e qasjes teknike të ofertuesit për dy shtyllat kryesore të angazhimit.

Pikët Përshkrimi

- 0 Nuk paraqitet asnjë qasje teknike domethënëse për Shtyllën 1 ose Shtyllën 2.
- 1 Qasja është e përgjithshme dhe trajton vetëm në mënyrë sipërfaqësore Shtyllën 1 dhe/ose Shtyllën 2.
- 2 Qasja trajton të dyja shtyllat, por me nivel të kufizuar detajimi, sekuencim të dobët ose shpjegim të pamjaftueshëm mbi mënyrën se si do të realizohen produktet e kërkuara.
- 3 Qasja është e përshtatshme dhe mbulon aktivitetet kryesore të Shtyllës 1 dhe Shtyllës 2, përfshirë strategjinë, planifikimin e biznesit, zbatimin dhe mbështetjen PMO, por mungon thellimi në disa komponentë.
- 4 Qasja është e fortë, e detajuar dhe praktike, duke mbuluar këshillimin strategjik në kuadër të Shtyllës 1 dhe zbatimin operacional në kuadër të Shtyllës 2, përfshirë shtyllat e punës, produktet, instrumentet dhe rezultatet e pritshme.
- 5 Qasja është gjithëpërfshirëse, teknikisht e konsoliduar dhe e përshtatur për BZH-në, duke mbuluar validimin e Projekt-Planit (Blueprint), analizën krahasuese, planin industrial, planin e biznesit, modelin financiar, materialet e qeverisjes, mbështetjen PMO, si dhe shtyllat e punës për aspektet ligjore dhe të qeverisjes, financimit, produkteve, riskut, TIK-ut, burimeve njerëzore, operacioneve dhe koordinimit me palët e interesit.

3. Plani i zbatimit, organizimi dhe struktura e stafit — 0–3 pikë

Ky kriter vlerëson realizueshmërinë e planit të propozuar të punës dhe nëse ofertuesi ka organizuar ekipin dhe burimet në një mënyrë të përshtatshme për realizimin e kontratës.

Pikët Përshkrimi

0 Nuk paraqitet një plan zbatimi, afat kohor, strukturë stafi apo model organizimi i besueshëm.

1 Plani i zbatimit ose struktura e stafit është bazike, e paplotë ose e lidhur në mënyrë të pamjaftueshme me etapat dhe produktet e përcaktuara në Termat e Referencës.

2 Plani i zbatimit është përgjithësisht i realizueshëm dhe përfshin etapat kryesore, sekuencimin e aktiviteteve, organizimin e ekipit, rolet dhe përgjegjësitë, por me kufizime në nivelin e detajimit ose të mekanizmave të koordinimit.

3 Plani i zbatimit është i detajuar, realist dhe i harmonizuar me afatet e përcaktuara në Termat e Referencës, duke përfshirë Master PMP, afatin e përfundimit të Shtyllës 1, kohëzgjatjen e plotë të kontratës, sekuencimin e shtyllave të punës, alokimin e stafit, modelin e qeverisjes, matricën RACI, linjat e raportimit dhe mekanizmat e eskalimit.

4. Sigurimi i cilësisë, evidenca, certifikimi, menaxhimi i riskut dhe kontrollet PMO — 0–3 pikë

Ky kriter vlerëson nëse ofertuesi ka propozuar mekanizma të mjaftueshëm kontrolli për të garantuar cilësinë e produkteve, verifikimin, pranimin, certifikimin dhe disiplinën e zbatimit.

Pikët Përshkrimi

0 Nuk paraqitet asnjë qasje domethënëse për sigurimin e cilësisë, evidencën, certifikimin, menaxhimin e riskut apo kontrollet PMO.

Kriteri	Pikët	Përshkrimi/Detajet
1		Përshkruhen mekanizma bazikë të kontrollit të cilësisë ose të PMO-së, por ato janë të përgjithshme dhe të lidhura dobët me produktet, paketat e evidencës, kriteret e pranimit ose certifikimin sipas përcaktimit në Termat e Referencës.
2		Metodologjia përfshin mekanizma të përshtatshëm për sigurimin e cilësisë, raportimin, evidencën, pranimin, certifikimin, menaxhimin e riskut dhe të problematikave, por disa elemente kërkojnë detajim të mëtejshëm.
3		Metodologjia paraqet një kuadër kontrolli të fortë dhe praktik, duke përfshirë rishikimin e cilësisë, matricën e adresimit të komenteve, paketat e evidencës, skedarët burimorë të editueshëm, kriteret e pranimit, certifikatat e realizimit të rregullt të shërbimeve, regjistrin e riskut, regjistrin e problematikave, mekanizmin e ndjekjes së varësive, procesin e kontrollit të ndryshimeve, raportimin PMO dhe dokumentacionin e mbylljes.

Metoda e llogaritjes

Për secilin ofertues, komisioni i vlerësimit fillimisht cakton një pikëzim bruto për secilin prej katër kriterëve të mësipërme.

$$Ok = C1 + C2 + C3 + C4$$

Ku:

Komponenti	Maksimumi
C1 — Përputhshmëria, plotësia dhe kuptimi i Termave të Referencës	4
C2 — Qasja teknike për Shtyllën 1 dhe Shtyllën 2	5
C3 — Plani i zbatimit, organizimi dhe struktura e stafit	3
C4 — Sigurimi i cilësisë, evidenca, certifikimi, menaxhimi i riskut dhe kontrollet PMO	3
Maksimumi Ok	15

Shërbimet do të kenë një kohëzgjatje maksimale prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Shtylla 1 duhet të përfundojë brenda 4 (katër) muajve të parë. Shtylla 2 mund të fillojë njëkohësisht me

Kriteri	Pikët	Përshkrimi/Detajet
---------	-------	--------------------

Shtyllën 1. Duke qenë se projekti ka rëndësi të lartë për vazhdimësinë e operacioneve të BZH-së, përparësi do t'i jepet periudhës më të shkurtër të mundshme të zbatimit (për totalin e Shtyllës 1 dhe Shtyllës 2). Ofertuesi që propozon afatin më të shkurtër për zbatimin e projektit, por jo më të shkurtër se 10 muaj, do të marrë pikët maksimale (20 pikë), ndërsa ofertuesit e tjerë do të renditen në mënyrë zbritëse. Nuk lejohet propozimi i një afati zbatimi që tejkalon periudhën e përcaktuar në Termat e Referencës.

Për këtë kriter, zbatohet formula e mëposhtme:

$$P_{k1} = \frac{V_{mink1} \times P_{maxk1}}{O_{k1}}$$

Afati i
Zbatimit

0–20 Ku:

- P_{k1} = pikët e dhëna për kriterin që vlerësohet;
- V_{mink1} = vlera më e ulët e ofertuar për kriterin që vlerësohet;
- P_{maxk1} = pikët maksimale të përcaktuara për kriterin që vlerësohet;
- O_{k1} = treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Baza ligjore për vendosjen e këtyre kriterëve:

LIGJ Nr. 162/2020, PËR PROKURIMIN PUBLIK, i ndryshuar:

Baza ligjore për vendosjen e këtyre kriterëve:

Bazuar në nenin 87 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në VKM-në nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si metodë vlerësimi ofertën ekonomikisht më të favorshme mbi bazën e kostos.

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar:

Në përputhje me VKM-në nr.285, për kontratat e shërbimeve me natyrë intelektuale, vlerësimi i ofertave bazohet jo vetëm në elementin ekonomik, por edhe në cilësinë e propozimit teknik, metodologjinë e zbatimit, eksperiencën në angazhime të ngjashme dhe kapacitetet profesionale të stafit të propozuar, në raport me kërkesat e kontratës.

Neni 45, pika 9 “Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës

fituese do të jetë “oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë.”

Udhërrëfyesit të APP “Mbi përdorimin nga autoritet/entitet kontraktore të kriterit të vlerësimit “Oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto”, sipas njoftimit nr. 6876 prot., datë 04.10.2024, i cili parashikon përdorimin e kësaj metode vlerësimi për kontratat e shërbimeve me natyrë intelektuale dhe konsulence, ku vlerësimi i cilësisë së propozimit teknik dhe ekspertizës profesionale konsiderohet element thelbësor për realizimin e kontratës.

Justifikimi për kërkesën e diplomës Master: Kjo kërkesë është përfshirë pasi objekti i prokurimit lidhet me shërbime komplekse konsulence intelektuale për zhvillimin e kuadrit strategjik dhe operacional të Bankës Shqiptare të Zhvillimit. Angazhimi përfshin strategjinë, planifikimin e biznesit, modelimin financiar, ngritjen institucionale, qeverisjen, PMO/zbatimin, menaxhimin e riskut, TIK-un, burimet njerëzore, operacionet, produktet, mekanizmat e financimit dhe koordinimin me palët e interesit. Këto aktivitete kërkojnë njohuri të avancuara analitike, teknike, menaxheriale dhe profesionale, çka justifikon kërkesën për një kualifikim universitar të ciklit të dytë për profilet Partner dhe Menaxher/I Lartë.

Kërkesa është proporcionale dhe e lidhur ngushtë me kapacitetin zbatues, natyrën dhe vlerën e kontratës, në përputhje me nenin 41, pika 2, të VKM-së nr. 285/2021, i ndryshuar. Ajo nuk synon të krijojë një kufizim të pajustificuar të konkurrencës, por të garantojë që personeli kyç i propozuar për zbatimin e kontratës zotëron formimin akademik të avancuar të nevojshëm për kompleksitetin e shërbimeve.

Në të njëjtën kohë, Autoriteti Kontraktor nuk e ka kufizuar kërkesën vetëm në një lloj specifik diplome Master. Kjo pasi angazhimi është multidisiplinar dhe kërkon ekspertizë në disa fusha, përfshirë financën, ekonominë, administrimin e biznesit, kontabilitetin, bankën, menaxhimin, ligjin, sistemet e informacionit, TIK-un, riskun, qeverisjen, menaxhimin e projekteve dhe fusha të tjera relevante për objektin e shërbimeve. Kufizimi i kriterit vetëm në një titull specifik diplome nuk do të pasqyrojë natyrën e Termave të Referencës dhe mund të kufizonte në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Kjo qasje merr në konsideratë edhe dallimet ndërmjet sistemeve kombëtare të arsimit dhe klasifikimeve të diplomave.

Justifikimi për kërkesat minimale të eksperiencës profesionale për profilet Partner dhe Menaxher/I Lartë: Kjo kërkesë është përfshirë pasi objekti i prokurimit lidhet me shërbime komplekse konsulence intelektuale për zhvillimin strategjik dhe operacional të Bankës Shqiptare të Zhvillimit, një Institucion Kombëtar Promovues i sapokrijuar. Angazhimi përfshin strategjinë, planifikimin e biznesit, modelimin financiar, ngritjen institucionale, qeverisjen, mbështetjen PMO/zbatimin, menaxhimin e riskut, TIK-un, burimet njerëzore, operacionet, produktet, mekanizmat e financimit, koordinimin me palët e interesit, verifikimin e produkteve, pranimin dhe certifikimin.

Neni 77, pika 1, i ligjit nr. 162/2020 parashikon që kërkesat e kualifikimit mund të lidhen me përshtatshmërinë e operatorit ekonomik, gjendjen ekonomike dhe financiare, si dhe aftësinë teknike dhe profesionale. Gjithashtu, parashikohet që këto kërkesa duhet të kufizohen në atë që është e përshtatshme për të garantuar që ofertuesi ka kapacitetin ligjor, financiar, teknik dhe

profesional për të zbatuar kontratën, dhe që të gjitha kërkesat duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Neni 41, pika 2, i VKM-së nr. 285/2021, i ndryshuar, parashikon më tej që kërkesat e veçanta të kualifikimit për kontratat e shërbimeve duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me kapacitetin zbatues, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe që autoriteti kontraktor duhet të specifikojë dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë për të provuar përmbushjen e tyre.

I njëjti kuadër rregullator njih gjithashtu që, për kontratat e shërbimeve, autoriteti kontraktor mund të kërkojë informacion dhe dokumentacion lidhur me personelin kyç, CV-të, kualifikimet profesionale, fuqinë punëtore dhe disponueshmërinë e stafit të nevojshëm për realizimin e kontratës. Në veçanti, për shërbimet intelektuale ku aspektet fizike nuk mbizotërojnë dhe kërkohet ekspertizë e specializuar, stafit të angazhuar mund t'i kërkohet të paraqesë deklarata disponueshmërie për shërbimet që merr përsipër të realizojë.

Partneri / Drejtuesi Teknik kërkohet të ketë të paktën dhjetë (10) vite eksperiencë profesionale, përfshirë të paktën tetë (8) vite eksperiencë të provuar konsulente në institucione financiare, banka zhvillimi, institucione financiare publike europiane ose entitete të krahasueshme. Kjo justifikohet pasi Partneri është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm, cilësinë strategjike, menaxhimin e palëve të interesit në nivel të lartë, miratimin e produkteve përpara dorëzimit dhe angazhimin e burimeve. Këto përgjegjësi kërkojnë eksperiencë të lartë profesionale, ekspertizë sektoriale dhe eksperiencë në mjedise komplekse këshillimore. Kërkesa nuk kufizohet vetëm te bankat e zhvillimit ose NPI-të, por pranon gjithashtu institucione financiare, institucione financiare publike europiane dhe entitete të krahasueshme, duke ruajtur konkurrencën dhe duke reflektuar veçantinë e angazhimeve identike me fazën aktuale të zhvillimit të BZH-së.

Profili Menaxher/I Lartë kërkohet të ketë të paktën gjashtë (6) vite eksperiencë relevante në strategji, planifikim industrial, PMO, shërbime financiare, institucione publike zhvillimi ose angazhime të krahasueshme. Kjo justifikohet pasi niveli Menaxher/I Lartë është përgjegjës për realizimin e përditshëm të aktiviteteve, mbikëqyrjen e shtyllave të punës, hartimin e produkteve komplekse, zgjidhjen e problematikave dhe koordinimin me ekipet e BZH-së. Pragu prej gjashtë vitesh është proporcional me përgjegjësitë operationale të rolit dhe i nevojshëm për të reduktuar riskun e zbatimit, veçanërisht duke pasur parasysht shtyllat paralele të punës, afatin katërmujor për Shtyllën 1 dhe objektivin e gatishmërisë operationale të angazhimit.

Për rrjedhojë, kërkesat minimale për eksperiencë janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, proporcionale me natyrën dhe vlerën e kontratës, të nevojshme për realizimin me sukses të saj, objektivi i të verifikueshme përmes CV-ve dhe dokumentacionit mbështetës, si dhe të hartuara mjaftueshëm gjerë për të shmangur kufizimin e pajustificuar të konkurrencës.

Justifikimi për Strukturën e Pikëzimit

1. Struktura e përgjithshme e pikëzimit

Propozohet që oferta fituese të përzgjidhet mbi bazën e 100 pikëve totale, të ndara si më poshtë:

Kriteri kryesor	Pikët maksimale Pesha	
Oferta Financiare për Shtyllën 1	10 pikë	10%
Oferta Financiare për Shtyllën 2	10 pikë	10%
Oferta Teknike	80 pikë	80%
Totali	100 pikë	100%

Kjo strukturë pasqyron natyrën e kontratës si një shërbim konsulence me karakter intelektual që kërkon ekspertizë të specializuar. Struktura 80/20 është në përputhje me nenin 45 të VKM-së nr. 285/2021, i ndryshuar, për shërbimet intelektuale/të konsulencës, ku cilësia teknike ka rëndësi dominuese, ndërsa çmimi ruan peshën minimale prej 20 pikësh të kërkuar ligjërisht.

Formula e përgjithshme është në përputhje me metodologjinë e parashikuar në nenin 45 të VKM-së nr. 285/2021 dhe me Udhëzimin nr. 6876 Prot., datë 04.10.2024, të APP-së, të cilat kërkojnë që çdo kriter të ketë të përcaktuar paraprakisht një formulë ose metodologji pikëzimi.

2. Justifikimi i kriterëve financiarë

2.1 Oferta Financiare për Shtyllën 1 – 10 pikë

Justifikimi për përfshirjen e kriterit: Shtylla 1 përfshin komponentët kryesorë strategjikë të kontratës, përfshirë kuadrin strategjik, Projekt-Planin (Blueprint), planin industrial, planin e biznesit, analizën krahasuese, modelin financiar dhe materialet për vendimmarrje strategjike. Sipas Termave të Referencës, Shtylla 1 duhet të përfundojë jo më vonë se T0 + 4 muaj dhe përbën bazën mbi të cilën do të ndërtohet operacionalizimi i mëtejshëm i Bankës.

Për këtë arsye, oferta financiare për Shtyllën 1 duhet të vlerësohet veçmas. Kjo i mundëson Autoritetit Kontraktor të krahasojë drejtpërdrejt koston e komponentit strategjik, pa e bashkuar atë me shërbimet afatgjata të zbatimit dhe mbështetjes PMO në kuadër të Shtyllës 2.

Justifikimi i peshës prej 10 pikësh: Pesha prej 10 pikësh është e arsyeshme pasi Shtylla 1 ka rëndësi të lartë strategjike, por kontrata në tërësi nuk duhet të jepet kryesisht mbi bazën e çmimit. Cilësia e analizës, modelit financiar, planit industrial dhe materialeve për vendimmarrje strategjike është më kritike sesa arritja e një kursimi marginal në çmim.

Për rrjedhojë, çmimi i Shtyllës 1 vlerësohet, por me një peshë të kufizuar brenda totalit prej 20 pikësh financiare.

Metoda e llogaritjes: Ky është një kriter me tendencë zbritëse, pasi çmimi më i ulët merr pikët maksimale.

2.2 Oferta Financiare për Shtyllën 2 – 10 pikë

Justifikimi për përfshirjen e kriterit: Shtylla 2 përfshin mbështetjen për zbatim dhe PMO, operacionalizimin e kuadrit strategjik, koordinimin e shtyllave të punës, produktet, riskun, TIK-un, burimet njerëzore, proceset, raportimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit. Sipas Termave të Referencës, Shtylla 2 mund të fillojë paralelisht me Shtyllën 1 dhe mund të vazhdojë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Duke qenë se Shtylla 2 është e ndryshme në natyrë nga Shtylla 1, pasi lidhet me zbatimin, koordinimin, PMO-në, produktet, riskun, operacionet dhe monitorimin, çmimi i saj duhet të vlerësohet veçmas. Kjo garanton transparencë mbi koston e shërbimeve të zbatimit dhe shmang situatën ku një ofertues mund të propozojë një çmim artificialisht të ulët për një komponent dhe ta kompensojë atë në komponentin tjetër.

Justifikimi i peshës prej 10 pikësh: Peshë prej 10 pikësh garanton që kostoja e Shtyllës 2 të merret në konsideratë, pa cenuar nevojën kryesore për cilësi teknike. Shtylla 2 përfshin mbështetje të vazhdueshme për operacionalizimin e Bankës dhe kërkon staf, metodologji, menaxhim projekti dhe mekanizma kontrolli.

Për këtë arsye, çmimi është relevant, por nuk duhet të dominojë mbi cilësinë e shërbimit.

Metoda e llogaritjes: Edhe ky është një kriter me tendencë zbritëse.

3. Justifikimi i Ofertës Teknike – 80 pikë

Oferta Teknike ka peshën kryesore prej 80 pikësh pasi objekti i prokurimit është një shërbim konsulence me natyrë intelektuale dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen institucionale të BZH-së.

Neni 45 i VKM-së nr. 285/2021 lejon dhe mbështet përdorimin e një peshe dominuese teknike për këtë kategori shërbimesh, përfshirë vlerësimin e eksperiencës së konsulentit, cilësisë së metodologjisë dhe kualifikimeve të stafit kyç.

Oferta Teknike ndahet si më poshtë:

Kriteri teknik	Pikët maksimale
2.1 Eksperienca në Angazhime / Shërbime të Ngjashme	25 pikë
2.2 Kualifikimet dhe Kompetencat Profesionale të Stafit	20 pikë
2.3 Metodologjia e Zbatimit të Projektit	35 pikë
Totali i kriterit teknik	80 pikë

Kjo strukturë pasqyron në mënyrë të balancuar tre faktorët kryesorë të suksesit: eksperiencën institucionale të operatorit, cilësinë e ekipit të propozuar dhe cilësinë e metodologjisë së zbatimit.

3.1 Eksperienca në Angazhime / Shërbime të Ngjashme – 25 pikë

Justifikimi për përfshirjen e kriterit: Eksperienca në shërbime të ngjashme është e nevojshme pasi objekti i prokurimit lidhet me ngritjen strategjike dhe operacionale të një institucioni financiar publik në fazën e tij të zhvillimit. Termat e Referencës kërkojnë ekspertizë në strategji, planifikim biznesi, ngritje institucionale, qeverisje, PMO, produkte, risk, TIK, burime njerëzore, thesar, kursime postare dhe operacione.

Justifikimi i peshës prej 25 pikësh: Pesha prej 25 pikësh justifikohet pasi eksperienca e mëparshme është një tregues i rëndësishëm i aftësisë së operatorit për të menaxhuar kompleksitetin e projektit. Megjithatë, eksperienca nuk merr peshën më të lartë, pasi realizimi me sukses i kontratës nuk varet vetëm nga referencat e mëparshme, por edhe nga cilësia e metodologjisë dhe ekipi specifik i propozuar për këtë angazhim. Për rrjedhojë, dhënia e 25 pikëve për eksperiencën, brenda totalit prej 80 pikësh teknike, ruan balancën ndërmjet kapacitetit të provuar dhe cilësisë së ofertës konkrete të paraqitur.

Metoda e llogaritjes: Ky kriter vlerësohet si kriter me tendencë rritëse, pasi sa më e lartë të jetë vlera e kontratës së ngjashme të provuar, aq më i lartë konsiderohet niveli i kompleksitetit dhe kapacitetit të demonstruar. Ofertuesi me vlerën më të lartë të kontratës së ngjashme merr 25 pikë. Ofertuesit e tjerë pikëzohen në mënyrë proporcionale. Kjo metodë është në përputhje me formulën për kriteret me tendencë rritëse sipas nenit 45 të VKM-së nr. 285/2021.

3.2 Kualifikimet dhe Kompetencat Profesionale të Stafit – 20 pikë

Justifikimi për përfshirjen e kriterit: Ky kriter është i nevojshëm pasi shërbimet do të realizohen nga ekspertë individualë dhe cilësia e tyre ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e produkteve përfundimtare. Në shërbimet intelektuale, kapaciteti real i kontraktorit lidhet jo vetëm me kompaninë, por veçanërisht me ekspertët kyç të propozuar. Termat e Referencës kërkojnë role dhe aftësi të ndryshme: drejtim strategjik, menaxhim projekti, ekspertizë financiare, risk, TIK, operacione, burime njerëzore, qeverisje, produkte, koordinim me palët e interesit dhe transferim njohurish. Kjo justifikon vlerësimin e stafit të propozuar si kriter i veçantë vlerësimi.

Justifikimi i peshës prej 20 pikësh: Pesha prej 20 pikësh është proporcionale pasi cilësia e stafit është e rëndësishme, por jo faktori i vetëm. Një ekip i fortë pa një metodologji të qartë nuk garanton realizim të suksesshëm. Në të kundërt, edhe një metodologji e mirë pa ekspertë të kualifikuar është e pamjaftueshme. Për rrjedhojë, 20 pikë për stafin krijojnë një balancë të arsyeshme ndërmjet eksperiencës së operatorit, cilësisë së ekipit dhe metodologjisë.

Në dokumentin e vlerësimit, ky kriter ndahet ndërmjet profileve kryesore: Partner, Menaxher/I Lartë dhe Nivel Fillestar (Junior). CV-të janë nominative dhe zëvendësimi i personelit kërkon miratim paraprak nga BZH-ja. Kjo e bën kriterin të verifikueshëm dhe të lidhur me performancën reale të kontratës.

Metoda e llogaritjes: Ky kriter mund të llogaritet përmes kombinimit të:

- një formulë me tendencë rritëse për elementët numerikë, si vitet e eksperiencës ose numri i projekteve relevante; dhe
- tabelave fikse të pikëzimit për diploma, certifikime dhe trajnime.

Për elementët e kualifikimit të stafit, pikët jepen sipas tabelave të paracaktuara të pikëzimit, për shembull:

- 0 pikë nëse nuk ka certifikim shtesë;
- 1 pikë për një certifikim relevant;
- 2 pikë për më shumë se një certifikim relevant;
- pikë shtesë për diplomë PhD / doktoraturë, sipas përcaktimeve në dokumentet e tenderit.

Kjo metodë është e përshtatshme pasi disa elemente janë objektivisht numerikë, ndërsa të tjerët janë të verifikueshëm përmes dokumenteve formale, por jo domosdoshmërisht të matshëm përmes një formule krahasuese. Kriteri mbetet objektiv pasi tabela e pikëzimit bëhet publike paraprakisht dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë ofertuesit.

3.3 Metodologjia e Zbatimit të Projektit – 35 pikë

Justifikimi për përfshirjen e kriterit: Metodologjia është kriteri teknik më i rëndësishëm pasi kontrata nuk kërkon vetëm ekspertizë teorike, por edhe aftësi praktike për të organizuar, menaxhuar, realizuar, verifikuar dhe certifikuar një numër të madh produktesh brenda afateve të kufizuara.

Termet e Referencës kërkojnë që kontraktori të përgatisë, brenda T0 + 15 ditëve pune, Master PMP, planin e punës, grafikët Gantt, shtyllat e punës, etapat kryesore, planin e burimeve, varësitë, matricën RACI, regjistrat e riskut/problematikave/ndryshimeve, kalendarin e raportimit, regjistrin e produkteve dhe planin e faturimit.

Përveç kësaj, çdo produkt duhet të shoqërohet me një Paketë Evidence dhe duhet të kalojë procesin e rishikimit, pranimit dhe certifikimit. Për këtë arsye, cilësia e metodologjisë është kritike për të vlerësuar nëse ofertuesi i kupton siç duhet Termet e Referencës, mund të menaxhojë Shtyllën 1 dhe Shtyllën 2, mund të koordinojë shtyllat e punës dhe mund të garantojë kontrollin e cilësisë.

Justifikimi i peshës prej 35 pikësh: Pesha prej 35 pikësh justifikohet pasi metodologjia është elementi që lidh eksperiencën dhe ekspertizën me qasjen konkrete të zbatimit. Në rastin e BZH-së, ku Banka ndodhet në fazën e zhvillimit dhe gatishmërisë operacionale, një metodologji e dobët mund të shkaktojë vonesa në strategji, paqartësi në strukturat e qeverisjes, mangësi në gatishmërinë operacionale dhe vështirësi në certifikimin e produkteve. Për këtë arsye, metodologjia meriton peshën më të lartë teknike.

Pesha prej 35 pikësh pasqyron faktin që metodologjia duhet të vlerësojë jo vetëm një narrativë të përgjithshme, por edhe: kuptimin e Termave të Referencës, qasjen ndaj Shtyllës 1 dhe Shtyllës 2,

planin e zbatimit, organizimin e stafit, sigurimin e cilësisë, paketat e evidencës, certifikimin, menaxhimin e riskut dhe kontrollet PMO.

Metoda e llogaritjes: Rekomandohet që 35 pikët për metodologjinë të ndahen si më poshtë:

Nën-kriteri	Pikët
C1 – Përputhshmëria, plotësia dhe kuptimi i Termave të Referencës	4 pikë
C2 – Qasja teknike për Shtyllën 1 dhe Shtyllën 2	5 pikë
C3 – Plani i zbatimit, organizimi dhe struktura e stafit	3 pikë
C4 – Sigurimi i cilësisë, Paketa e Evidencës, certifikimi, menaxhimi i riskut dhe kontrollet PMO	3 pikë
C5 – Afati / kalendari i zbatimit	20 pikë
Totali	35 pikë

Për C1–C4, pikët jepen sipas shkallëve përshkuese të pikëzimit të përcaktuara paraprakisht në dokumentet e tenderit. Kjo është e pranueshme pasi këto elemente janë cilësore, por bëhen objektivist të krahasueshme përmes niveleve të paracaktuara të pikëzimit.

Për C5 – afatin e zbatimit, kriteri është me tendencë zbritëse, pasi afati më i shkurtër i pranueshëm merr më shumë pikë, me kusht që të mos jetë më i shkurtër se afati minimal i lejuar dhe të mos tejkalojë afatin maksimal sipas Termave të Referencës.

Kriteret parashikojnë që periudha e zbatimit nuk mund të jetë më e shkurtër se 10 muaj dhe nuk mund të tejkalojë 16 muaj. Afatet më të shkurtra se minimumi i lejuar nuk duhet të marrin pikë shtesë, pasi mund të jenë jorealiste dhe të krijojnë rreziqe për cilësinë.